


Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



DREJTORIA E ARSIMIT

Datë: 26.11.2024

PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS

2024/2026

Nëntor 2024

Përbajtja

Listë e shkurtesave	3
Hyrje	4
Konteksti.....	5
Qëllimi i planit të veprimit.....	11
Objektivat	13
Shtojca.....	30

Shkurtesat

MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DKA	Drejtori të Komunale të Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KN	Këshilli i nxënësve
KP	Këshilli i prindërve
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoritetave

HYRJE

Janë një varg konventash dhe standartesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, astësie e gjendje tjeter.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit para universitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konverte, shtetet orientojnë politikat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ: **Mes diskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithë përfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, astësie e gjendje tjeter, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rinjt, Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, etj., bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitet e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj

i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkoħshem i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kérkojnë bashkëveprimin e plotë pér tē funksionuar si hallka tē shtetit nē adresimin e problemeve me tē cilat ballafaqohemi.

Legislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që tē marrin tē gjitha hapat e arsyeshém që institucionet arsimore tē jenč cifosore, gjithëpërfshirëse, humane dhe tē sigurta, siç e kérkojnë politikat arsimore, përfshirë standarde pér shkollat mëke, kurikular dhe secilla hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave pér sigurimin e qasjes e barabartë nē arsim, zbatimin e ligjeve nē fuqi.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që pér prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithë përfshirjen nē arsim, si ēhe dokumentet tjera strategjike ndër sektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes nē arsim tē viktimate tē trafigimil, ënumës, krimít dhe rr Ethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion tē zbatimit tē këtyre politikave dhe konkretisht nē adresimin e pjesëmarrjes nē arsim ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të shkollës, pér tē siguruar që tē gjithë fëmijët, tē jenë përfitues tē sistemit arsimor dhe tē zhvillohen brenda potencialit tē plotë.

Konteksti

Komuna e Fushë Kosovës, është njera ndër komunat me dinamike në shtetin e Kosovës e cila është duke përfshirë zhvillim të hovshëm në të gjitha sferat e jetës, shtrihet në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës.

Fushë - Kosova është vendbanim i tipit fushor të grumbulluar, me qendër komunale të veten që nga viti 1989, me vëçori të një qyteti dinamik dhe urban i cili po ec me ritme të shpejtë të zhvillimit socio - ekonomik, urbanistik, edukativo/arsimor, kulturor o sportiv etj.

Drejtoria Komunale për Arsim me prioritet ka ngrijen e cilësisë në mësim, mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërisë në punë, zbatimin e reformave arsimore të dala nga Ligji për Arsimin në Komunat e Kosovës, zbatimin e Kurrikulës së re të arsimorit, pastaj rrijen e disiplinës, përgjegjësisë dhe llogaridhënieς, krijimin e kushteve të mira teknike në punë për të gjithë stafin arsimor, ngrijen e kapaciteteve të stafit arsimor përmes trajnimeve dhe rikualifikimeve që organizohen nga MASHT-i, nga DKA-ja, vëcanërisht për arsimtarët e rinjë dhe ata mësimdhënës të profileve profesionale.

Me fokus në planin dinamik të DKA mbetet instrumenti i kontrollit dhe mbikëqyrjes profesionale në të gjitha institucionet edukativo-arsimore për punë dhe rezultate me të mira në sistemin e arsimit lokal.

Gjithsej numri i shkollave në nivel parauniversitar në Komunën e Fushë - Kosovës është 13-të, nga numri i përgjithshëm prej 13- shkollave rezulton kjo pasqyrtë: Nëntë (9) Shkolla të Mesme të Ulta (fillore), tri Shkolla të Mesme të Larta (një gjimnaz dhe dy profesionale) si edhe dy institucionë parashkollore, njëra në kuadër të sistemit publik dhe tjetra nga sektori publiko/privat.

Te gjitha shkollat janë të pajisura me internet (WIFI) dhe kabinete të informatikës, po ashtu në të gjitha shkollat janë zbutur masat e energjisë eficiente, sistemi nxemjes qëndrore, dritare të plastikës, etj.

Në kuadër të DKA-së me prioritet ka qenë edhe fusha e Ed.fizike, sportit dhe shëndetit; Deri me tanë kemi arritur të ndertojmë 13 fusha sportive me bari sintetik (artificial) dhe 11 salla apo palestra sportive në kuadër të çdo institucioni shko'llor.

Po ashtu elemntit të sigurisë në shkolla i kemi kushtuar vemandje të veçantë, të gjitha shkollat e Komunës së Fushë - Kosovës i kemi pajisur me kamera të sigurisë përgjatë 24 orëve , objektet shkollore janë të rrethuara sipas standardeve të vendit, pastaj kemi ndërtuar raporte të shkëlqyshme bashkëpunimi me Policinë e Kosovës rreth sigurisë së nxënësve në shkollë etj.

Ndër prioritetet ka qenë që të gjitha shkollat të janë të pajisura me mjete laboratorike në lëndën e kimisë, biologjisë, fizikës, me tendencë për të furnizuar të gjitha kabinetet me pajisje të domosdoshme. Gjatë këtij viti shkollor 2023/24 të gjithë mësimdhënësit, në të gjitha shkollat në komunën e Fushë- Kosovës tanë e tutje mund të shfrytëzojnë nëpër klasa mësimore gjatë orëve mësimore projektoret dhe Lap/Top, investim nga DKA. Ndërsa me laborator me të sofistikuar është Shkolla e Mesme e Lartë ‘Hivzi i Sulejmani’ e cila posedon kabinete dhe laboratore të mjaftushme për punët praktike dhe gjashtë shkolla në fshatrat e komunës: Lismir, Grabovë, Bardh i Madh, Sllatinë e Madhe, Miradi e Poshtme, shkolla fillore e Mesme e Ultë ‘Daut Bogujevci’ si dhe Shkolla Fillore e Mesme e Ultë ‘Selman Riza’ në Fushë - Kosovë.

Tëtë shkolla fillore janë të pajisura me biblioteka shkollore si dhe shkolla e Mesme e Lartë - Gjimnazi ‘Hivzi Sulejmani’, gjithashtu 9 institucionë janë të pajisura me biblioteka.

Të gjitha institucionet shkollore janë të pajisura me orendi të domosdoshme shkollore, mjedis të bukur dhe të sigurt shko'llor për të gjithë nxënësit duke përfshirë edhe ata të komuniteteve. Mbetet të punohet për kushte dhe mjedis shkollor me të mirë për nxënësit me nevoja të veçanta.

Të gjitha shkollat e Komunës, në të gjitha klasat janë pajisura projektor (300 klasa), ndërsa gjimnazi ‘Hivzi Sulejmani’ ka edhe një tabelë elektronike (SMART), si dhe SHFMU ‘Mihal Grameno’ dbe Aneksi I janë të pajisura me televizor të cilët kanë qenë donacione.

Gjatë vitit shkollor 2022/23 të gjitha drejtoritë e shkollave kanë raportuar në DKA për suksesin e nxënësve në fund të gjysmë vjetorit dhe në fund të vitit shkollor.

Në vitin 2023 mësimi është zhvilluar në 9 shkolla fillore (amë) ku një është në gjuhen serbe, me 8 paralele të ndara që tri shkolla të mesme (drejtimet – gjimnaz, ekonomiko-juridik dhe teknik). Numri i gjithmbarshëm i nxënësve në komunën e Fushë-Kosovës ne shtator të vitit shkollor 2022-23 është si në vijim.

Numri i përgjithshëm i nxënësve nga parashkollori deri në klasën e 12 në shkollat e komunës tonë është 10493 nxënës në gjutën shqipe dhe 88 nxënës që ndjekin mesimin në gjuhën serbe.

Në shkollat e mesme vërehet një rënje e lehtë e numrit të nxënieve për arsyen se në komunën tonë nuk i kemi të gjitha profilet ku nxënësit janë të interesuar.

Numri i nxënësve braktisës në komunën e Fushë - Kosovës është 35 nxënës,

Objektet mësimore në qytetin e Fushë-Kosovës janë shumë të ngarkuara për shkak të numrit të madh të nxënësve mirëpo në këtë vit është duke u ndertuar një objekt i ri cili do të jetë në funksion gjatë vitit të ri shkollor 2024/25.

Megjithatë sfidë për DKA-në në Fushë - Kosovë mbetet problemi se ende ballafaqohemi me mungesë të stafit të rijaftueshëm profesional, mandaj kemi kapacitete të limituara teknike me vetëm një veturë në dispozicion të drejtorisë komunale o cilla në mënyrë indirekte vështirson edhe funksionimin EPRBM-së komunale dhe atyre në shkolla.

Gjithashtu në shumicen e shkollave funksionaliteti i ekipeve të EPRBM-ve ballafaqohet me sfida të shumta, të cilat përfshijnë natyrën e punës në teren, koordinimin e domosdoshëm ndërinstitucional, trajnimet e vazhdueshme të ekipeve, takimet me prindër që nxënës e shumë angazhime të tjera, të cilat kanë edhe implikime buxhetore.

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

Shënimet për vitin shkollor 2022/2023

Nr	Emërtimi	Vlerat
1	Shkolla	13 shkolla
2	Numri i nx:	I-V: 5296 VI-IX: 3441 X-XII: 1416 36 fillor+53sh.m
3	Numri i nxënësve të braktisës për një vit shkollor 2023	22 fillor+3 sh.m
4	Numri i nxënësve pa prindër	232 fillor+53 sh.m
5	Numri i nxënësve me një prind	37 fillor+3 sh.m
6	Nxënës me aftësi të kufizuar	78 fillor+4 sh.m
7	Numri i nxënësve me nevoja të veqanta	

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

8	Numri i nxënësve të familjeve përfituese të ndihmes sociale	109 fillor+17 sh.m
9	Numri i nxënësve me vështirësi në të nxënë	175 fillor-10 sh.m
10	Numri i nxënësve me mungesa të shumta	422 fillor+127 sh.m
11	Numri i nxënësve në rrezik të braktisjes	54 fillor-8 sh.m

Qëllimi i planit të punës

Koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të desyriimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zhvogëlinin e braktisjes.

Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

Objektivat specifike:

- 1.1 Funksionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i rasteve të braktisjes në nivel komune;
- 1.2 Koordinimi ndërinstitucional dhe me partnerë zhvillimore në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3 Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe ofrimi i mbështetjes kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ulja e përqindjes së rasteve të braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitet e karrierës që përpunhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

Objektivat specifike:

- 2.1. Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 5-të

- 2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave që ndihmojnë të fëmijës;
- 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës
- 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucionale përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në fazë periodike.

Rezultatet kryesore të pretenduara:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes
- Funksionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/ zvogëlimi i braktisjes

Buxhetimi:

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 8.950,00 €.

Monitorimi:

Zbatimin e këtij plani e monitoron EPRBM komunal, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërohet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashtëmuajore dhe vjetor.

Plani Komunal i Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026

Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBMve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim								
Objektiva specifike 1.1; Funksionalizimi i EPRBM-ve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune								
Nr.	Aktivitet	Aktivitetet e përshkruara /Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
1.1.1	Funksionalizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	<p>Mostra e planit të veprimit dhe verifikimi nga akterët e tjera.</p> <p>Vendimi dhe përshkrimi i përgjegjësive, procesverbalet, takimet e rregullta, (4 takime në vit, dhe të tjera sipas nevojës)</p>	x	x	x	DKA	Komuna MASHTT	Pa kosto
1.1.2	Funksionalizimi dhe fuqizimi i EPRBM në të gjitha shkollat e arsimit	<p>Vendimi me përshkrim të përgjegjësive për EPRBM-të shkollore</p> <p>Shkolla gjithsej 13 shkolla</p>	x	x	x	SHKO LLA	DKA Mashti Partneret	Pa kosto

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

	parauniversita r							
1.1.3	Takime informuese dhe koordinuese, EPRBM komunale me EPRBM-të shkollore	Agjendat, listat e pjesëmarrjes dhe procesverbalet, rekomandimet. (4 Takime në vit, dhe takime të tjera sipas nevojës) 13 shkolla pjesëmarrëse	x	x	x	EPRB M komun ale	Mashti Partnerët	OJQ 300.00 Euro/ per vit
1.1.4	Trajnim për EPRBM-të shkollore dhe komunale	Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve të ekipës rrëth parandalimit të braktisjes, menagjimit të rasteve etj. Agjendat, listat e pjesëmarrjes, materialet, certifikatat.	x			EPRB M komun ale	DKA/MASHTI/OJQ	1,500.00Euro
1.1.5	Seanca mbështetëse për EPRBM-të shkollore	Agjendat, lista e pjesëmarrjes dhe raportet për rastet e mbështetura. (2 seanca në vit dhe sipas	x	x	x	DKA	MASHTI Institucionet komunale Partnerët	Donatorët

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

		nevojës seanca shtesë)						
1.1.6	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorimin e SPH-së (Sistemi i paralajmërimit të hershëm) EMIS	Identifikimi i shkollave ne nevoje për asistence. Nr. i takimeve, nr. i shkollave përfituese (13 shkolla)	x	x	x	DKA	MASHTI	Pa kosto
1.1.7	Tryeza diskutimi me artere të ndryshëm (p.sh. Drejtoret e shkollave, MASHT, Komiteti për Arsim, QPS, Policia, këshillin e prindërve, psikologet e shkollave)	Agjenda, lista e pjesëmarrësve, Raportet dhe rekomandimet (1 Tryeza diskutimi në vit)	x	x	DKA	MASHTI Partnerët	300.00 Euro/ne vit	

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitucional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë								
	Aktivitet	Aktivitetet e përshkruara/Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Budheti
			2024	2025	2026			
1.2.1	Takime koordinuese me partnerë	Dy takime, (takime shtese sipas nevojës) Partnerët: QPS, Policia, OJQ, Drejtoria e shëndetësisë,	x	x	x	DKA	MASHTI Partnerët	Pa kesto
1.2.2	Zhvillimi i projekteve ndër sektoriale në parandalim të dukurive negative që e sfidojnë vijimin e rregullt në shkollë, të gupeve të	Nr. i projekteve, aktiviteteve ndërgjegjësuese (1 në vit) Aktivitete Për ngritjen e vetëdijes me qëllim të parandalimit të dukurive negative të cilat mund të ndikojnë në braktisjen e shkollimit) Nr. i shkollave përfituesse		x	x	DKA-SHKOLLA	Drejtori të tjera komunale dhe policia në komunitet Partnerët	150.00

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2025

	caktuara të nxënësve	(14) Nr. i nxënësve përfitues (varësisht nga raportet e shkollave) Policia e komunitetit, psikologët e shkollave, drejtoria e shëndetësisë, OJQ)					
1.2.3	Mbështetja e nxënësve në nevojë përmotivimin e shkollimit të qëndrueshëm.	Nr. i nxënësve përfitues (sipas nevojës) nga pedagoget dhe psikologët e shkollave ne bashkëpunim me kujdestaret e klasës. Pako mbështetëse, përkrahja e bashkëmoshatareve.	x	x	DKA	Kuvendi komunal/Partnerët	Donatorët 3,000.00 Euro
1.2.4	Aktivitete ndërgjegjësues e përpunën e lejuar të fëmijëve	Ligjërate informuese me nxënës, mësimdhënës, staf drejtues të shkollës dhe këshillin e prindërve rrëth informimit përpunën e lejuar të	x	x		QPS, DKA, ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT	Pa kosto

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

		fëmijëve/nxënësve Nr. Ligjératave vetëdijësuese; 1 ligjërate në vit me nxënës, një me mësimdhënës dhe staf të shkollës, një me këshillin e prindërve dhe firmat bashkëpunuese. (Tetor) QPS, psikologët, pedagogët.					
1.2.5	Fushate sensibilizuese neper lagje për regjistrimin e fëmijëve ne klase te pare.	Takimet me prindër dhe fëmije Broshura Pos tera etj	x	x	DKA shkolla	DKA Partneret Donatoret	2,000.00 Euro
Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresit akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.							
	Aktivitet	Aktivitetet e përshtkuara/Treguesit	Afat kohor	Instituc ioni përgjeg ës	Institucionet mbështetëse	Buxheti	
			2024	2025	2026		

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

1.3.1	Zhvillimi i një sistemi të regjistrit kumulativ për nxënësit e klasave 6-9	Regjistri i zhvilluar me te dhënat qe nuk regjistrohen ne ditar. Evidencat Mbështetja e mësimdhënësve per mënyrën e aplikimit/ruajtja e privatësisë se regjistrave) 13 Shkolla	x	x	x	DKA shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
1.3.2	Sigurimi i trajnimeve përmesuesit dhe administratorët e shkollave se si të mirëmbajnë dhe përdorin sistemin e regjistrit kumulativ;	Trajnimet e zhvilluara	x	x	DKA MASHT I	Partnerët	Pa kosto	
1.3.3	Takim me Drejtorin e DKA-se, me prindërit, mësuesit dhe	Takimet e realizuara 1 Takim në vit	x	x	x	Shkollat	DKA	Pa kosto

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

	administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe jo akademik të nxënësve						
1.3.4	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit e komuniteteve dhe nxënësit që kanë vështirësi akademike ose personale;	Takim ne sallën e sporteve i prindërve me kryetarin e komunës për ti identifikuar problemet dhe vesh tersit e sistemit. Identifikimi i nxënësve me vështersi ne mesimnxenje nga personeli i shkollës (Analfabet funksional) Aktivitete e realizuara, 1. Mësim plotësues sipas nevojës individual/grupor) 2. Aktivitete verore çdo vit, me nxënësit e moshës 9 -12 vjet. Ku do të përfshihen	x	x	DKA shkollat	MASHTI MEF	1,000.00 Euro

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

		nga dy shkolla me nga 100 nxënës përfitues për vit. Ekipi EPBRM- së në bashkëpunim me psikologët dhe pedagogët, si dhe punën vullnetare të studentëve.						
1.3.5	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe çështjet e sjelljes.	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat 13 shkolla	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	Pa kosto

Objektiva e përgjithshme 2. Ulja e përqindjes së braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitet e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve.

Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të

Nr.	Aktivitetet	Aktivitetet e përshkruara/Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-9	<p>U.A. numër 18/2023</p> <p>Themelimi i grupit të karrierës në të gjitha shkollat, hartimi i planit të veprimit për vizitat në shkollat profesionale, panairet dhe organizimi i aktiviteteve me folës motivues.</p>	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	
2.1.2	Organizimi i panaireve të karrierës për t'i ekspozuar	Organizimi i panaireve në kam pusin e SHML, dhe panaireve brenda shkollave, duke ftuar	x	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	200.00 Euro

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

	nxënësve para profesioneve të ndryshme dhe mundësi punësimi.	profesionist të fushave ndryshme për të promovuar drejtimet e tyre, rolin e tyre në ato pozita dhe përfitimet prej pozitave të caktuara. 1 Panair në vit					
2.1.3	Angazhimi i këshilltarëve për orientimin në karrierë në shkollat e mesme të ulëta për t'u ofruar nxënësve këshilla dhe mbështetje profesionale.	Në çdo shkollë këshilltari i karrierës tu ofroj nxënësve nga klasa VI deri IX këshilla grupore dhe individuale për orientim në karrierë Nr. i këshilltarëve të karrierës të punësuar në shkolla (në proces të zbatimit të UA në fuqi, në mungesë të këshilltarit të karrierës këtë ta bëjë (psikologu dhe pedagogu) i shkollës	x	x	DKA	MASHTI	MASHTI DKA
2.1.4	Hartimi i një programi që i ndihmon	Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla,	x	x	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

	nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarjen, i cili përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.	pos tera, fletëpalosja 1 Herë në vit						
2.1.5	Organizimi i vizitave të nxënësve të klasës 9 në SHML	Vizitë në SHML, çdo vit të punës, vizita të organizohet me të gjithë nxënësit e klasave të nënta, në mënyrë që ata të eksplorojnë më tepër drejtimet e ndryshme dhe të njihen nga afér me mundësitet që i ofron shkolla, që çdo nxënës të zhvillohet në kapacitetet dhe aftësitë e tij. Orari i vizitave dhe koordinimi në mes të	x	x	x	DKA-Shkolla	OJQ,Bizneset	Pa kosto

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

		nivelit të mesém të ulët dhe mesém të lartë. 1 herë në vit Raportet dhe fotot e vizitave						
2.1.6	Organizimi i vizitave nga nxënësit e klasës së 9 në institucion/biznese	Realizimi i vizitave te planifikuara nga këshilltari i karrierës dhe këshilltari për biznese Raportet dhe foto të vizitave 10 SHMU 1 Herë në vit	x	x	x	DKA-Shkolla	OJQ,Bizneset	Pa kosto

Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës

	Aktivitetet	Përshtaki i aktiviteteve/Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.2.1	Përgatitja e materialeve	Çdo SHML, njëherë në vit të përgatit broshura me	x	x		Shkollat	MASHITI	1,500.00

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

						DKA	Partnerët	Euro
	informuese për prindër dhe nxënës.	informacione për të gjitha profilet që ofrojnë dhe ato ti shpërndaj në të gjitha SHFMU. 1 herë në vit Materialet e përgatitura(Broshura, postera,video mesazhe etj.)						
2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta për të eksploruar interesat dhe aftësitë e tyre.	Këshilltari i karrierës me stafin ndihmës të realizoj seminare me nxënës të klasave VI_IX, ku nxënësit mund të eksplorojnë interesat dhe aftësitë e tyre . Nr. 1 seminar ne vit i realizuar me nxënës (agjenda, lista e pjesëmarrësve dhe dëshmitë e formave të punës/foto),këshilltari i karrierës, psikologu dhe pedagogu	x	x	Shkollat (këshilltari i karrierës në bashkëpunimine Ekipin profesional dhe mësimdhënësitet klasave të	MASHTI Partnerët	Pa kosto	

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

					nënta) DKA	MASHTI DKA	Partnerët	Pa kosto
2.2.4	Takime senzibilizuese me prindër, nxënës dhe folës motivues.	Secila shkollë duhet të marrë përsipër organizimin e takimeve sensibilizuese me prindër, nxënës dhe folës motivues të fushave të ndryshme, dhe këtë ta realizoj në periudhën e II-Të të vitit shkollor. Takim për një vit shkollor	x	x	Shkollat DKA	MASHTI DKA	Partnerët	Pa kosto
2.2.5	Hulumtim për numrin e të regjistruarve pas mbarimit të shkollimit të mesëm të ulët	Evidenca e nxënësve të regjistruar në SHML	x	x	x	DKA/S HKOLL A		Pa kosto
Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.								

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

	Aktivitetet	Përshkrimi i aktiviteteve /Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.3.1	Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit	Nr. i marrëveshjeve dhe i takimeve me partnerë	x	x		Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	

Objektiva specifike 2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimit

	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.4.1	Zhvillimi dhe aprovimi i kornizës monitoruese	Korniza monitorues e zhvilluar (takimet,aktivitetet, trajtim i rasteve)	x			DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
2.4.2	Mbledhja e të dhënavë sipas kornizës monitorues	Të dhënata e mbledhura(statistikat dhe raportet)	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto

Plani komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024/2026

2.4.3	Analiza e të dhënavë	Të dhënrat e analizuara(konkluzionet dhe rekomandimet)	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto
2.4.4	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit	Raportimi i rregullt vjetor	x	x	x	DKA Shkollat	MASHTI Partnerët	Pa kosto

Shtoja : Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë

Ligjet

- Kushtetuta e Kosovës,
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji nr. 2003/12 për Qasjen në dokumente zyrtare, 6 nëntor 2003, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2470>
- Ligji nr. 03/L – 172 për Mbrojtjen e të dhënave personale, 31 Maj 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2676>
- Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 1 Mars 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

Udhëzimet administrative

- Udhëzimi administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsiminparauniversitar <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-nr-08-2018-per-themelin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhе-kbmnapu/>
- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat që institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 d'jetor 2012, <https://masht.rks-gov.net/9-ua-per-mbledhjen-dhe-raportimin-e-te-dhenave-statistikore-nga-shkollat-dhe-institucionet-parashkollore-ne-arsimimin-parauniversitar-duke-perdorur-sistemin-per-menaxhimin-e-informativ-ne/>
- U.A për transferin e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/16-ua-per-kalimin-e-nxenesit-te-shkolles-sc-mesme-te-larie-prej-nje-profil-arsimor-ne-tjetrin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeter-nr-16-2011-date-30-12-2011/>
- UA. 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht->

[nr-08-per-dokumentacionin-shkollar-ne-arsimin-parauniversitar /](#)

- U.A 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-njohja-e-dokumenteve-te-arsimit-parauniversitar-te-leshuara-jashte-republike-sse-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- U.A. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sistemin-e-nxenesve-te-cilet-kane-migruar-nga-viti-shkollor-2014-2015/>
- U.A. 1/2016, Percaktimi i kushteve, kriterieve dhe procedurave për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit e riadhesuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-dt-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kritereve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mesimit-plotesues-per-nxenesit-e-riatdhesuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- U.A 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-aftezin profesional/>.
- U.A 02/2014 Numri i nxënëse me module dhe kualifikime te AAP, resurset, infrastrukturadhe siguma e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-02-2014-numri-i-nxenesve-me-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>
- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta <https://czk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>
- UA- MASHT Nr: 12/2014 Përjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rinjtë <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-12-2014-perjashtimet-ne-moshe-me-rastin-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-aftezin-per-e-rritur/>

(Politika për mësimin dual ka filluar nga shtatori 2022 fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe murator)

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimit, me synimin që në secilën komunë të bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimi për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërlidhen me punën që e bëjnë nxënësit

nën moshën 18 vjet.

Strategjitet kombëtare/planet e veprimit

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023),
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2022-2026).

Të tjera

- Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)
- Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (MASHT, 2023)
- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), *Trajtimi i refuzimit të shkollës dhe braktisjeve: doracak i orientuar kah praktika [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual]* (tetor 2011).
- Raporti i OSBE-së: *Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë* <http://ee.ee.osce.org/sq/kosovo/95113?doenload=true> (qasur më 24 mars 2014).
- *Registrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë (MASHT & UNICEF2004).*
- *Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë (MASHT, 2008)*
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, *Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë* (2014)
- UNICEF, Përbledhje e Politikave - *Të gjithë fëmijët registrohen, vijojnë dhe përfundojnë arsimimin*, 2014.

Plani i Veprimit Nr. 148 2024

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



**EKIPI PËR PËRGATITJEN E PLAN VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOS REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

- 1. ELMIE GRAJÇEVCI ZYMBERI**, kryesuese e ekipit
- 2. VLORA BERJANI**, anëtar
- 3. MIRANDA SYLEJMANI**, anëtare
- 4. AMIR PLLANA**, anëtare
- 5. ARTA HYSINI**, anëtare